



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 3, datë 28.01.2021

PËR
MBARIMIN PËRPARA AFATIT TË MANDATIT TË KËSHILLTARIT
Z.ARBEN ISAKU

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë “Qeverisja Vendore” e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, neni 47, gërma “c”, neni 49, pika 4, gërma “c”, pika 5, neni 54 pika “j”, neni 55, pika 6, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të Rregullores së Funkionimit të Këshillit Bashkisë Durrës datë 29.04.2020, mbështetur në raportin e Komisionit të Mandateve,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Mbarimin para afatit të mandatit të këshilltarit të Këshillit Bashkiak Durrës z. Arben Bashkim Isaku, për shkak se merr një funksion të papajtuëshëm me funksionin e Këshilltarit.
2. Të shpall vakancën në Këshillin Bashkiak Durrës.
3. Për këtë vendim të njoftohet Komisionin Qëndror i Zgjedhjeve.
4. Në komisionin e Rregullores, Çështjeve Juridike përkohësisht në vënd të tij emërohet këshilltari z.Jurgen Zaza, në Komisionin e Zhvillimit Urban dhe Përdorimin e Tokës përkohësisht në vënd të tij emërohet këshilltari z.Indrit Cërloj.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sekretari Këshillit Bashkiak.
6. Ky vendim me karakter individual hyn në fuqi në datën e njoftimit të subjekteve që përfshihen në të.


KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.01.2021





2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. ~~89~~ / prot.
3



Durrës, më 02.02.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 03 datë 28.01.2021
“Për mbarimin përpara afatit të mandatit të këshilltarit Arben Isaku.”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016
“Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

